

Shkrimi, leximi dhe historia e shkrimeve

Sami Frashëri

Të mësuarit e dijes, dhe më drejtë, të artit të shkrim-leximit, nuk është një gjë e madhe, por dobia që arrihet nga kjo është shumë e madhe. Për aq sa të ketë dallim midis një njeriu memec e të shurdhër dhe një njeriu që dëgjon e flet mirë, po aq ka dallim midis njeriut që nuk di shkrim-lexim dhe atij që di këtë. Ndoshta dallimi midis këtyre është edhe më i madh. Sepse, memeci me disa isharete mund ta kryejë detyrën të cilën do ta kryente gjuha, dhe ato isharete edhe të shurdhërit mund t'ia shpjegojnë qëllimin e dëshirën. Mirëpo, njeriu i cili nuk di shkrim dhe lexim në asnjë mënyrë nuk mund t'i kryejë punët të cilat i kryejnë me shkrim dhe lexim ata që e dinë këtë.

Njeriu, nga kafshët tjera ndryshon dhe dallohet me forcën e të folurit, pra me forcën që të mund të shpreh me fjalë atë që dëshiron. Ndërsa, që të mund të shprehë atë që dëshiron, njeriu ka në dorë dy mjete: njëri prej tyre është të folurit që është dhunti e natyrës dhe dhuratë e Zotit, dhe tjetri është shkrimi që është një mjet arti. Edhe pse shkrimi nuk është diç tjetër pos përfytyrimit (konceptimit) të të folurit, kryen punë më shumë se vetë të folurit dhe është edhe më i dobishëm për punën. Derisa me të folur mundemi tua shprehim atë që dëshirojmë vetëm atyre që janë përballë nesh, me shkrim jemi në gjendje tua shprehim qëllimin tonë edhe atyre që janë larg nesh, në hapësirë dhe kohë. Atë që e themi, duke bërë ta dëgjojnë një ose disa persona që janë pranë nesh, për një sekond fluturon e zhduket, dhe ai që e thotë bashkë me ata që dëgjojnë atë e harrojnë e tretet. Ndërsa fjala që e shkruajmë do të mund të lexohet nga njerëzit që ndodhen krejt në anën tjetër të rruzullit tokësor dhe nga ata të cilët do të vijnë pas disa qindra apo pas disa mijëra vjetëve. Njeriu që nuk di të lexojë do të ketë nevojë për fjalët e thjeshta të një njeriu tjetër. Ndërsa njeriu që di të lexojë, për të folur, nuk ka nevojë të kërkojë njeri dhe kur e merr në dorë një libër të përbërë nga disa fletë prej letre flet me mendimtarët më të mëdhenj të botës e me njerëz të famshëm që kanë ardhur e kanë kaluar para qindra e mijëra vitesh. Dhe kështu mëson me qindra gjëra që nuk mund të shpjegohen (komentohen) me fjalë dhe fiton njohuri.

Prandaj, derisa njeriu që nuk di shkrim-lexim e meriton t'i thuhet njeri vetëm për shkak se posedon aftësinë e të folurit duke e dalluar nga kafshët tjera, për njeriun që di shkrim-lexim mbi titullin "njeri" duhet të jetë një titull. Midis njerëzve që nuk kanë sukses t'i mësojnë dhe të përfitojnë nga dijet dhe shkencat e ndryshme, por që janë të aftë që ta shprehin mendimin e dëshiruar në formë të shkruar dhe që një mendim të shprehur në formë të shkruar ta kuptojnë dhe midis atyre që nga kjo janë të privuar ka shumë dallime. Ashtu sikundër arti i shkrim-leximit është mjet dhe ndërmjetës për nxënien e të gjitha dijeve e shkencave, po ashtu është edhe një art që është mëse i nevojshëm dhe i dobishëm, dhe ndoshta një mrekulli që e dyfishon fuqinë natyrore të njeriut.

Për këtë arsye, nuk lejohet që asnjë njeri të jetë i privuar nga arti i shkrimit dhe leximit. Në vendet e qytetëruara duke mos lejuar që as të verbërit, memecët e të shurdhërit të mbeten të privuar nga arti i shkrim-leximit, janë botuar libra special me shkrim të fryrë (të prekshme) për të verbërit, ndërsa për të shurdhërit dhe memecët germa me forma të ndryshme që kuptohen me gishta të dorës. Atyre ua kanë mësuar të kuptojnë mesazhin e çdo gjëje që është e shkruar dhe me shkrim të shprehin ato që dëshirojnë. Qoftë për të verbërit, qoftë për të shurdhërit e memecët në çdo vend ka shkolla speciale. Edhe njerëzit pa krahë mësohen të shkruajnë me këmbë apo me gojë. Po si mund të lejohet të privohet nga arti i shkrimit-leximit një njeri që nuk është me ndonjë të metë të këtillë natyrore?

Kur kështu qëndron puna, gjendja e tërë asaj pjese të njerëzimit e quajtur masë e gjerë dhe fshatarë gati në të gjitha anët e botës është aq shumë e lënë pas dore, saqë edhe në vendet më të qytetëruara janë të privuar nga dhuntia e shkrim-leximit. Rreth kësaj çështjeje, nga të gjitha shtetet edhe pse Gjermania është më e lumtura, edhe atje nga e gjithë popullata 75% dinë shkrim dhe lexim, një çerek prapë është analfabete. Përderisa popullata e Anglisë është në një shkallë mahnitëse të përparimit material e moral, rreth kësaj çështjeje është edhe më mbrapa gjermanëve e francezëve, dhe numri i atyre që dinë shkrim-lexim është më pak se gjysma e popullatës. Te ne (mbase Samiu mendon në gjithë Perandorinë Osmane), nëse bëhet një llogaritje statistikore për këtë temë, nuk ka dyshim se numri i personave që dinë shkrim e lexim në përpjestim me popullatën e përgjithshme nuk do të

dalë më shumë se një përqind. Te arabët dhe në Iran numri i personave që dinë shkrim e lexim është pak më i madh.

Një popull e komb që do të përparojë dhe të qytetërohet, gjëja e parë që duhet të mendojë është çështja e përhapjes së artit të shkrim-leximit në një shkallë sa më të gjerë të i gjithë populli. Pasi të bëhet kjo, përhapja dhe përgjithësimi i dijeve dhe shkencave të ndryshme do të jetë një rezultat i natyrshëm. Te ne, shkak i mosdhënies së fryteve sipas përpjekjes që është bërë në mënyrë shtetërore për përhapjen e domosdoshme të dijes dhe shkencës, qëndron nga fakti se nuk është punuar për shkaqet e përhapjes së artit të shkrimit e leximit, që është baza e të gjitha dijeve dhe shkencave.

Për përhapjen e artit të shkrimit dhe leximit nuk duhet harruar se pikësëpari duhet thjeshtësuar dhe lehtësuar këtë. Ky art, përhapjen e së cilit sot e konsiderojmë shumë të nevojshëm, në një kohë ishte i veçantë vetëm për shtresën e lartë dhe për klasën (klerin) fetare dhe për popullin tjetër, pra për popullatën tjetër, për masën e gjerë ishte i ndaluar. Dhe në disa vende mësohej përmendësh të hedhurit fall. Në ato kohëra, jo vetëm që nuk punohej për thjeshtësimin e lehtësimin e artit të shkruarit e të lexuarit, por përkundrazi, shtrohej si nevojë që ky të dukej si problem i pazgjidhshëm (enigmatik), në një shkallë sa të jetë e mundur të vështirë e enigmatikë. Ndërsa, shkrimet që sot janë në përdorim të shumica e popujve nuk janë nga zbulimet e reja, dhe meqë janë vepra të mbetura nga ato kohëra të vjetra, sado që të jenë munduar disa popuj të qytetëruar që në një formë t'i thjeshtësojnë dhe t'i lehtësojnë, nga ato vështirësi (probleme) të vjetra prapë kanë mbetur disa gjurmë. Sado që çdo gjuhë mund të shkruhet e të lexohet shumë mirë, me një sasi midis njëzet e katërdhjetë shkronjash të përcaktuara, që për nevojat e domosdoshmërinë e disa gjuhëve janë pak e për disa shumë, shkronja këto që të shumtën janë rregulluar (hartuar) sipas nevojave të disa gjuhëve të tjera, shumë gjuhë janë duke shkruar me shkronja që nuk u përshtaten nevojave të veta dhe për këtë arsye janë duke lindur shumë vështirësi e probleme. Në sajë të ndikimit të këtyre vështirësive dhe problemeve boshe e të padobishme, për t'i nxënë e përvetësuar tërësisht disa shkrime kërkohet përkushtim pesëdhjetë vjet. Mirëpo, fëmijët e bujqve e të zanatlinjëve nuk kanë mundësi që një kohë aq të gjatë të qëndrojnë në shkollë, edhe ata që duan që shkollimin e tyre ta shpiejnë më tutje, tërë pjesën kohore të arsimimit të tyre e

kalojnë duke mësuar vetëm artin e shkrimit dhe leximit dhe nuk mundën të gjejnë kohë aq sa nevojitet për nxënien e dijeve e shkencave të ndryshme. Në Kinë, një njeri për të mësuar shkrim dhe lexim, vazhdimisht mëson deri në moshën shtatëdhjetëvjeçare dhe prapë këtë art nuk mundet ta përsosë dhe vdes pa e arritur qëllimin e dëshiruar. Për t'u arsimuar me një shkrim të këtillë as e gjithë jeta nuk mjafton.

Ja, njëri nga shkaqet kryesore që shumicën e njerëzimit e lë në gjendje analfabetike dhe pjesën më të madhe të rruzullit tokësor të privuar nga qytetërimi, dhe që pengojnë përhapjen e mirëqenies dhe të lumturisë të vendet që janë të qytetëruara, është fakti se janë disa vështirësi dhe papërshtatshmëritë e këtilla të shkrimeve që përdoren te popujt e ndryshëm. Ashtu siç janë Anglezët në industri, punë përpara të gjithë popujve, në çështjen e shkrimit e të leximit janë prapa francezëve, e francezët kanë mbetur prapa gjermanëve, dhe kjo vetëm për shkak se gjermanishtja e ka të lehtë shkrimin dhe leximin, e frengjishtja më të vështirë, ndërsa anglishtja është prijëse me situatën e saj plotësisht me vështirësi. Po ashtu edhe arsyeja se në Iran numri i atyre që dinë shkrim e lexim është më i madh se te ne, është se persishtja krahas turqishtes, më lehtë shkruhet e lexohet; dhe nëse jo diçka tjetër, për shkak se rregullat e shkrimit dhe të ortografisë janë të zgjidhura e të rregulluara mirë. Çfarë keqardhje, arsye që me miliona njerëz të mbeten në errësirën e injorancës e në primitivizëm. Janë pesëdhjetë vija që i quajmë germa!

Shkurtimisht, me përhapjen e artit të shkrim-leximit, detyra kryesore në të cilën duhet të përqendrohemi është lehtësimi dhe thjeshtësimi. Në mënyrë që kështu të përhapen dijet e shkencat dhe të qytetërohet njerëzimi. Vështirësitë e shkrimit tonë* në veçanti janë në atë shkallë që të mos pranohet krahasimi me vështirësitë e anglishtes, e cila në këto çështje është më e vështira nga gjuhët e Evropës. Edhe pse dëshirojmë përhapjen e artit të shkrim-leximit dhe përhapjen e arsimit në vendet tona, ne së pari duhet të punojmë për organizimin dhe lehtësimin e shkrimit tonë.

Në të ardhmen, përgjithësisht, do të japim njohuritë dhe vërejtjet tona rreth gjendjeve dhe historisë së gjuhëve në përgjithësi, dhe në veçanti, për mangësitë dhe vështirësitë e gjuhës sonë, gjithastu edhe për mënyrën se si do të mund të përmirësohen ato.

Historia e shkrimeve

Nuk dihet se ku, në ç’kohë dhe nga kush është shpikur shkrimi për herë të parë. Dihet vetëm ajo që, të parët të cilët janë munduar të gjejnë një mënyrë për të komunikuar me sojin e tyre të largët, cilëndo qofshin këta, nuk e kanë gjetur rrugën që fjalët të cilat fliten përbëhen nga disa tinguj (zëra). Kësisoj, duke caktuar një figurë të posaçme për çdo zë, të nxirrin një kuptim e qëllim nga renditja dhe rregullimi i këtyre figurave. Në fillim ata patën menduar të kumtojnë disa mendime, për shembull, duke lidhur disa nyje në një litar, me anë të figurave ose gdhendjen konvencionale në ndonjë sipërfaqe. Megjithëse këto nuk mund të quhen shkrim, shkrimi ka lindur nga këto. Sepse kur fillojnë të zgjerohen dhe të shtohen gjërat që donin t’i komunikonin, për t’u marrë vesh me lehtësi kanë filluar të bëjnë figurën e çdo gjëje, ndërsa gjërat pa formë trupore i paraqitnin me figurën e gjërave e të trupave më të ngjashëm. Për shembull, mendjen e përshkruanin me figurën e një zogu që e konsideronin më të zgjuar dhe me figurën e një shtaze që në vrapim ishte më e shpejta. Ky shkrim që nga grekët u quajt “hieroglif”, d.m.th. “gdhendje të shenjta”, në kohën e lashtë është përdorur në dy vende, në Egjipt dhe në Kinë. Nuk dihet se cili nga këto dy shkrime që janë përdorur te këta popuj është më i vjetër, pra, cili prej tyre u shpik më përpara. Por, dihet se nuk është marrë njëri nga tjetri dhe që secili është shpikur në mënyrë të veçantë. Në ato kohëra midis Egjiptit dhe Kinës nuk ka pasur kurrfarë marrëdhënie dhe këto dy shkrime fare nuk mbështeten në ngjashmëri me njëri tjetrin. Hieroglifi i Egjiptit na paraqet një model të një guri të ngulitur në sheshin e vrapimit të kuajve, ishte më i përsosur dhe pothuaj është mjet që mund të shprehë çdo gjë. Hieroglifi kinez është i përbërë nga figurat në formë të vrazhdë, vetëm të gjërave materiale e trupore dhe nuk është i përshtatshëm për të shprehur një gjë shpirtërore. Edhe pse me zbulimin e Amerikës është gjetur një shkrim (ortografi) i një lloji hieroglifi, është vlerësuar shumë i vrazhdë dhe me mangësi.

Nga popujt semitë, guldanitët, sirianitët dhe në fund arabët, germat e tyre i kishin përdorur në formë të germave të bashkëngjitura dhe derisa këta fjalët i bashkojnë, abranitët dhe fenikasit këto i kishin përdorur në formë të germave të ndara (veçuara). Megjithëse, qoftë abranitë qoftë fenikasit, kishin disa lloje shkrimesh (grafishë), nga këto lloje, të cilat janë në përdorim te ne, janë grafitë si : nus’hi, ta’lik, rika’, kufi dhe magrebi. E prejardhja e tyre është një, edhe dallimet që janë

nga grafia guldaniye dhe sirianiye janë vetëm nga fakti se këto shkruhen në formën e germave të ndara (veçuara). Koptët, germat semite i kishin marrë nga fenikasit, duke ua shtuar edhe disa germa format e tyre i kishin rregulluar dhe zhvilluar mirë.

Një person me emrin Kademus nga Fenikia kishte kaluar në Greqi dhe germat e vatanit të tij ua mëson grekëve. Kështu, grekët kishin filluar t'i shkruajnë gjuhët e tyre me këto germa. Dhe ja atëherë, për herë të parë, grafia semite, me kalimin prej gjuhëve semite, kishte filluar të përdorej edhe te gjuhët arianite. Edhe grekët, fillimisht, sikur popujt semit, edhe pse kishin shkruar nga e djathta në të majtë, më pastaj duke mos i kushtuar kujdes shumë renditjes së radhëve kishin filluar të shkruajnë sikur lëvizja e hobes. Shkrim ky që shkon nga e djathta në të majtë dhe kthehet nga e majta në të djathtë, apo duke zbritur nga lartë poshtë, e duke dalur nga poshtë lartë. Në fund kishin marrë vendim për të shkruar gjithmonë nga e majta në të djathtë. Edhe koptët, më në fund, kështu kishin filluar të shkruajnë. Këtë ortografi nga grekët e kishin marrë edhe romakët dhe me disa modifikime dhe plotësime të pjesërishme kishin filluar ta përdorin në gjuhët e tyre, dhe kështu e kishin përhapur në Evropë. Edhe në Azi, iranianët pasi pushtuan vendet e popujve semitë, kishin filluar që gjuhët pehlevite t'i shkruajnë me shkronja sirianiye, dhe disa sirianitë këtë ortografi e kishin përhapur deri në Azinë lindore. Poashtu, edhe ujugurët, domethënë, turqit e vjetër dhe mogullët kishin filluar ta përdorin këtë në gjuhët e tyre. Pas shfaqjes së Islamit, iranianët dhe turqit edhe pse e kishin braktisur këtë shkrim, e kishin marrë ortografinë arabe që është vëllai i vogël i saj. Sot grafia arabe, ashtu siç përdoret te muslimanët e Indisë, pra te gjuhët indase, po ashtu përdoret edhe te muslimanët e ujdhesave të Oqeanit Atlantik, të cilët gjuhët e tyre që i përkasin familjes “Malai” qysh prej atëherë i shkruajnë me këtë grafi. Ashtu siç të gjithë popujt e Evropës kanë filluar t'i shkruajnë gjuhët e tyre me germa latine, dhe nga ky shkrim u shfaqën dy lloj shkrimesh, grafia latine dhe ajo gotike, edhe nga grafia greke lindën në fillim shkrimi ermenas dhe ai gjeorgjian, dhe në fund ai rus. Këto vitet e fundit, nga disa modifikime dhe përshtatje të pjesërishme të shkronjave latine dhe greke, ka lindur edhe një alfabet i ri, që është karakteristik për gjuhën shqipe.¹

¹ Këtu, me gjasë, Samiu mendon në alfabetin e tij – A. H.

Ndoshta është befasi (habi) se të gjitha këto grafi që i numëruam janë shpërndarë (degëzuar) nga një bërthamë. Vërtetë, kur i hidhet një shikim i sipërfaqshëm formave të këtyre grafive që përdoren sot, p.sh. ndonëse nuk vërehen ngjashmëri midis grafive arabe e latine, dhe ermene e abranije, sapo të hyhet pak në analizë dhe studim, bëhet e qartë se këto grafi nuk janë gjë tjetër pos të degëzuara nga një grafi burimore. Kështu që, është e ditur se nuk ka ndonjë ndryshim midis formës së grafisë *n e s* që përdoret te ne dhe të grafisë “Kevhi” që arabët e kanë përdorur para islamit dhe në kohë të lumturisë. Ndërsa, ndryshimi midis grafisë Kevhi dhe grafisë sirianije është edhe më i vogël se ky. Madje, ngjashmëria e grafisë Kevhi dhe asaj *T a ô dhe k R i k* na ka dyshim se është edhe më e dobët se ngjashmëria që është midis grafisë së përmendur dhe grafisë sirianije. Sikundër që nuk ka ndonjë dallim të dukshëm midis grafisë sirianije dhe asaj keldani, po ashtu edhe grafitë që janë në përdorim te gjuhët pehlevi, ujgure e mogulule janë të njëjtat e grafisë sirianije. Kur krahasohen grafitë e llojllojshme abranije dhe fenikije, shihet se sadoqë të jenë ngjashmëritë midis njëra tjetrës, po aq janë ngjashmëritë me germat e veçuara (ndara) të grafisë sirianije. Ndërsa, grafia kopte dhe greke është e qartë se nuk është diçka tjetër pos një lloj grafie fenikije që në vend se të vijë nga e djathta në të majtë ka ardhë në formë të kundërt. Midis grafisë së vjetër greke dhe grafisë së vjetër latine gati se nuk ka kurrfarë ndryshimi edhe dallimi që sot shihet qoftë midis këtyre dy grafive, qoftë midis grafisë latine e grafisë gote, e cila është marrë nga ajo dhe është përdorur te gjermanët, ka lindur nga ndryshimi midis shkrimeve të shkruessve para shpikjes së shtypshkronjës. Po ashtu është evidente se shkrimet ermeni dhe gjorgjije janë krijuar duke u adaptuar e shtuar germave greke dhe latine disa germa sirianije. Ndërsa për shkrimin rus dihet saktësisht koha kur është marrë nga grafia greke dhe se ishte përpunuar nga një prift.

Renditja e germave origjinale samiye shihet në shprehjen “Ebxhet hoz...”. Ashtu siç e kanë ruajtur atë renditje alfabetike gjuhët abranije dhe sirianije, po ashtu kujdes i njëjtë asaj renditje i është kushtuar edhe në format e shkrimeve grek e latin dhe të tjerë. Mirëpo, arabët duke u detyruar që germave origjinale sirianije t’ua shtojnë disa germa të tyre, dhe nga fakti se këto ishin me forma të njëjta por me shtuarjen e pikave, p. sh. si: ث ت ب = b, t, th dhe خ ح ج = xh, h, h

dhe për shkak se viheshin në një renditje, e kishin prishur rregullin origjinal të germave. Vetëm se në përdorimin e germave në rangimin numëror e kishin ruajtur rregullimin origjinal me lënien e fjalëve pa pika në formën e njohur “ebxhet...”. Është një argument se edhe emrat e germave janë nga origjinali i këtyre dhe se të gjitha shkrimet e përmendura lartë janë degëzuar nga grafia guldaniye, e dëshmon fakti që nga një anë këto emra përbëhen nga fjalët e gjuhëve semite², nga një anë argumentimi me histori se personi me emrin Kademus, që grekëve ua mësoi germat ishte një fenikas. P. sh.

Abrani: Alif, bet, xhemel (gamel), dalt, he, vav, zajin, hat, tet, jud, kaf, lamd, mim, nun, same, ajn, fe, sad, kaf, resh, shin, tav.

Arabisht: Elif, ba, xhim, dal, ha, vav, za, ha, ta, ja, kaf, lam, mim, nun, sin, ajn, fa, sad, kaf, ra, shin, ta (me renditje ebxhed)...

Greqisht: Alfa, beta, (vita), gama, zelta (delta), eh (he), * , zeta, heta, (ejta), juta, kapa, lamda, mi, ni, kasi, a, pi, * , * , rev, sima, taf ...

Po të ishte mundur t'i siguronim germat burimore të ortografive që i numëruam lartë, duke i vënë format e tyre pranë njëra tjetrës, do të mund të paraqitnim ngjashmëritë që ekzistojnë midis njëra tjetrës. Por, për shkak se në vendin tonë nuk ka mundësi për këtë, jemi të detyruar të mjaftohemi me kaq.

Përktheu:

Abdulla Hamiti

² Shpjegim i Samiut : elif = re's, ...